

UDHËZUES PËR PLOTËSIMIN E APLIKACIONIT PËR REGJISTRIMIN E MARKËS TREGTARE

Procedura e regjistrimit fillon me dorëzimin e aplikacionit të plotësuar në Agencinë për Pronësi Industriale.

Formulari merret në Agencinë për Pronësi Industriale në MTI, apo nga web- site zyrtar i Agencinë për Pronësi Industriale <http://kipa.rks-gov.net/> .

Aplikacioni për regjistrimin e markës tregtare plotësohet në gjuhën zyrtare vetëm me kompjuter. Aplikacioni nuk duhet të plotësohet me dorë. Disa shpjegime për plotësimin e këtij formulari:

Rubrika 2

Emri, mbiemri (për personin fizik) apo emri i plotë (për personin juridik) adresa (të dhënat të shënohen sipas radhës): rruga, numri, numri postar, qyteti, shteti, tel/fax dhe e-mail adresa.

Rubrika 3- Të dhënat për përfaqësuesin

Emri dhe mbiemri (për personin fizik), apo për personin juridik (emri i plotë i personit juridik), adresa; rruga ,numri, numri postar, qyteti, shteti, tel, telefax, e-mail adresa.

Rubrika 4- Të dhënat për shenjën

Në këtë rubrikë janë të shënuara llojet e formave të markave tregtare. Varësisht nga lloji shënohet tipi apo lloji i markës.

Dukja e shenjës së markës tregtare duhet të jetë e fiksuar në formularë me përmasa minimale 1.5x1.5 cm dhe maksimale 8x8 cm.

Në rastet kur marka është e përbashkët kolektive dhe certifikuese është e domosdoshme të dorëzohet kontrata e shfrytëzimit.

Rubrika 5- Klasifikimi

Duhet rrethuar numri i klasës për produkte dhe shërbime sipas klasifikimit të Nicës. Klasifikimi i Nicës gjenden në linkun <http://kipa.rks-gov.net/page.aspx?id=1,8> .

Në faqen shtesë shënohet lista e produkteve apo shërbimeve për të cilat kërkohet mbrojtja.

Rubrika 6- E drejta e përparësisë Nëse kërkohet njohja e të drejtës së përparësisë që i referohet aplikacioni të dorëzuar më përpara, shënohen këto të dhëna: emri i organit dhe vendi ku është paraqitur aplikacioni i mëparshëm, numri dhe data e dorëzimit.

Nëse kërkohet njohja e të drejtës së përparësisë që i referohet pjesëmarrjes, përkatësisht ekspozimit të produkteve në ndonjë ekspozitë ndërkombëtare, shënohen këto të dhëna: emri i ekspozitës, vendi i mbajtjes dhe data e e hapjes dhe e mbylljës së ekspozitës.

Rubrika 7- Taksa e paguar

Bashkëngjitet dëshmia

Rubrika 8- Shtojcat e bashkëngjitura

Shënohen në katror përkatës:

Lista e produkteve dhe e shërbimeve, autorizimi, kontrata për markën kolektive, kontrata për markën certifikuese, dëshmia mbi të drejtën e përparësisë, dëshmia mbi pagesën e taksës

administrative, numri i faqeve shesë të paraqitura për pikat e shënuara në aplikacioni, numri i faqeve që përmban kërkesa dhe numrin e faqeve që i bashkëngjiten aplikacioni. Aplikacioni i plotësuar për regjistrimin e markës tregtare duhet ta ketë vulën e titullarit dhe nënshkrimin e tij apo të përfaqësuesit ndërsa, me rastin e dorëzimit, nënshkruhet dhe vulozet nga zyrtari i Agjencisë për Pronësi Industriale

Rubrika 9. Nënshkrimi apo vula e paraqitësit të aplikacionit.